

FJALA E DEPUTETES MERITA BAKIU

E ENJTE 27 JANAR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar qytetarë,

Mendoj dhe besoj se të gjithë ne që jemi në këtë sallë, mirëpresim çdo investim që ka të bëjë me studentët, por Partia Demokratike është e shqetësuar në lidhje me mungesën e transparencës, që ka të bëjë me projektin e rehabilitimit të konvikteve studentore të universiteteve publike në Shqipëri, që financohen nga qeveria Federale e Gjermanisë nëpërmjet KfW-së. Ashtu siç e kemi kërkuar edhe në Komisionin e Edukimit, edhe sot këtu kërkojmë transparencë dhe të hidhet dritë mbi disa fakte dhe pikëpyetje që kemi. Së pari, relacioni thotë se shuma e akorduar në formën e huas do të shërbejë vetëm për rehabilitimin e konvikteve të Universitetit të Tiranës, sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza e katërt. Opozita që në krye të herës ka ngritur pikëpyetje dhe ka kërkuar të dijë si kanë ecur fazat e këtij projekti. Pse nuk kemi një raport nga qeveria? Sa dhe si është shpenzuar? Së dyti, pse pjesë e bashkëbisedimit për këtë çështje nuk janë as aktorë të tjerë përfitues dhe zbatues, në këtë rast universitet dhe Bashkia e Tiranës? Pse qenka kaq e pamundur të dëgjojmë zërin e të gjithë aktorëve të përfshirë? Nga se keni frikë? Po ashtu, ne e shohim të rëndësishme që në diskutime të tilla të përfshijmë edhe zërin e studentëve. A janë ata të kënaqur? Për çfarë kanë më shumë nevojë këta studentë? Sa do të jenë kostot e akomodimit të tyre? Sa është fatura financiare që studentët duhet të paguajnë? Çfarë parashikon ky projekt për studentët me të ardhura shumë të ulëta?

Dua të nënvizoj këtu rëndësinë e të bërit të studentëve pjesë të këtij procesi. Skema e mbështetjes ndaj tyre duhet të jetë e qartë, sidomos për studentët e familjeve të varfra. Problematikat e studentëve sot janë të dukshme, që nga mungesa e ngrohjes në auditorë dhe në konvikte në këto ditë të ftohta dimri dhe deri te bursat e vitit të kaluar, që ende nuk janë marrë nga studentët. Kemi shumë studentë që studiojnë në Tiranë dhe jetojnë me ndihmë ekonomike, bursa, e madhe ose e vogël, që është caktuar nga shteti, për të është shumë e rëndësishme. Atë mezi e presin, ashtu siç presin të gjithë shqiptarët e thjeshtë rrogën në fund të muajit.

Ne kërkojmë që qeveria në këtë rast të zbatojë Paktin për Universitetin dhe të dëshmojë se nuk ishte thjesht një farsë për të gjuhëzuar protestën. Së treti, duam të theksojmë se në fillim u tha për një grant, por ndërkohë, sipas relacionit, është e qartë që shuma prej 20 milionë eurosh është një hua nga KfW-ja. A ka qeveria një studim të mirëfilltë? Sa do të kursejë buxheti i shtetit nga ky investim? Si ndikon kjo në borxhin publik? Pa këto përgjigje të rëndësishme, që ka në bazë transparencën dhe llogaridhënien para shqiptarëve dhe studentëve, ne nuk mund të votojmë symbyllazi. Kërkesat tona janë legjitime dhe të nevojshme për të rritur kontrollin dhe reagshmërinë për dritëhijet e këtij projekti. Ju gënjyet për procesin e rindërtimit të konvikteve kur premtuat se rindërtimi i rezidencave studentore do të përfundojë dhe do të jetë gati për të mirëpritur studentët këtë vit akademik, prandaj ne dhe studentët kërkojmë transparencë, garanci dhe siguri. Ku do të shkojnë paratë e shqiptarëve në këtë projekt. Nuk duhet të harrojmë këtu edhe anketimet e kryera nga disa organizata qytetare, që janë bërë që nga viti 2020 me studentët. Këto anketime dëshmojnë se gati 70% e studentëve mendojnë se investimet nuk kanë sjellë përmirësime të kushteve të ndërtesave dhe se ndërhyrjet janë

bërë vetëm në fasadë. Ndaj, insistojmë që këto investime të bëhen transparente dhe të shkojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së studentëve. Faleminderit!